VENDIM
Nr.931, datë 2.7.2008

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.335, DATË 2.9.1997 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR LËSHIMIN E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8668, datë 23.11.2000 "Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 4 të vendimin nr.335, datë 2.9.1997 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

"-Titullari i institucioneve qendrore, në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha